

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 26 SHKURT 2026

Kryesuesi I mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 22

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 22

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo dhe Drejtorë të Administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 2

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mirëdita të gjithëve fillojmë mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak rendi i ditës është shpërndarë. Hapim procesin e votimit për rendin e ditës, kush është dakort me rendin e ditës?

Edhe njëherë hap procesin e votimit, ju lutem këshilltarëve mos vonohemi.

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 22 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 2 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS DATËS 29 JANAR 2026”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka diçka nga këshilltarët?

Nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 22 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës.

“MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1- 31 JANAR 2026”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltare E.Mitre: Përshëndetje të gjithëve, ditën e hënë komisioni u mbledh për të shqyrtuar materialet e dërguara nga ekzekutivi edhe për muajin janar janë 41 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 % e fondit të kushtëzuar të cilat janë renditur në tabelën e përlogaritjeve sipas vendimit të Këshillit të Ministrave. Kemi 11 familje të cilat përfitojnë shumën 14 mijë e 168 lekë kompensimin e energjisë elektrike. Gjithashtu kemi nga fondi i buxhetit vendor 12 familje që përfitojnë shumën 62 mijë e 273 lekë. Dalin nga lista 21 persona për arsye të cilat janë të parashtruara në material, ju ftoj ta miratojmë këtë pikë të rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 22 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 4 e rendit të ditës.

“MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË GRANDIN E MENJËHERSHËM TË BANESAVE ME KOSTO TË ULËT NGA BUXHETI I SHTETIT”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem komisioni edhe njëherë.

Këshilltare E.Mitre: Siç e dimë të gjithë grandin e menjëherëshëm është një instrument financiar i cili lehtëson blerjen e banesave me kosto të ulët për disa familje që i përkasin kategorive të parashtruara në material. Ky grand akordohet nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë të Financave që mbulon çështjet e strehimit, kështu që përfitohet në masën 10 % të shitjes të banesave, përveç rasteve që janë të parashikuara në ligj kur grandin jep në masën 20 %, këtë muaj 4 familje, ju ftoj ta miratojmë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje apo diskutime nga këshilltarët?

Nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 24 këshilltarë, 24 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 5 e rendit të ditës.

“MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT, PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA DHE PJESËMARRJEN ME BASHKËFINANCIM”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem komisioni edhe njëherë.

Këshilltare E.Mitre: Atëherë në bazë të ligjit, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave dhe në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak dhe në bazë të materialit, miratohet 25 familje përfituese nga program i strehimit social, përmirësim i banesave ekzistuese sipas tabelës bashkëngjitur material. Programi bashkëfinancohet me fonde nga buxheti i Bashkisë Korçë në kufirin jo më pak se 50 % të koston të projektit dhe ka dhe masën 11 milion e 447 mijë e 257 lekë dhe masën 50 % nga buxheti i shtetit, ju ftoj ta miratojmë edhe këtë pikë të rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje apo diskutime nga këshilltarët?

Nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 26 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 6 e rendit të ditës.

“PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E VITIT 2026.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltar A.Habip: Janë 3 projekte me financim të huaj të miratuar nga Këshilli Bashkiak të vitit 2025, një është në datën 25 shtator që lidhet me projektin Ristor vlera e të cilit është 16 milion e 993 mijë e 362 lekë dhe dy të tjera të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, në datën 27 nëntor 2025, të cilat janë projekti Cross- Move me vlerë 90 milion e 40 mijë e 324 lekë si dhe

projekti Digital- Inovation- Unit me vlerë 2 milion e 12 mijë e 601 lekë. Vazhdimi i këtyre projekteve, ekzekutivi ka dërguar relacion për miratim me ndryshime në strukturën buxhetore gjithashtu të detajuar sipas programeve, komisioni vendosi t'ja kalojë Këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare doja të pyesja ekzekutivin nëse kjo pikë e rendit të ditës lidhet me ndryshimin e buxhetit dhe dua të di për këtë gjendjen e emergjencës të krijuar tani, mos vallë është e udhës që ne ta kemi një pikë ku të propozojmë ide sesi do lehtësojmë këtë vështirëse që po krijohet në aspektin social, ekonomik, tek bizneset dhe qytetarët sepse znj.kryetare nuk mund të hiqemi sikur s'ka ndodhur asgjë dhe të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës që janë parashikuar dy javë para. Ne ndryshojmë buxhetin për raste në veçanti por nuk lëvizim nga vendi për të propozuar ndryshime që mund të shërbejnë në dobi të ndryshimit të vështirësive.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Falemiderit me komentin që bëtë sepse nuk kishte lidhje me këtë pikë dhe këtë çështje të rendit të ditës. Do doja të përmbaheshim, është një pikë shumë sensitive dhe unë jam shumë e sigurt që do e diskutojmë në pika të ndryshme sepse jam shumë e sigurt që secili nga ne e ka po aq shqetësim çështjen e rrugës si edhe ju, por t'i përmbahemi rendit të ditës sepse ju erdhët edhe me vonesë. Kjo çështje e miratimit të kësaj pike të rendit të ditës nuk zgjidh apo buxheti i ndryshuar për to projekte nuk zgjidh çështjen e bllokimit të rrugës. Nëse keni pyetjen për këtë pikë të rendit të ditës, nëse nuk ke, këshilltarë të tjerë që kanë pyetje lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Këshilltar K.Pllaha: Për çështjen në fjalë doja të dija çfarë përfaqëson ky program që po pakësohet me këtë buxhet?

Ku ishin parashikuar të shkonin këto fonde të cilat do ndryshojnë?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje tjetër nëse jo një përgjigje nga ekzekutivi.

Drejtorja e Financës V.Ziko: Në material është cituar që të treja këto projekte janë miratuar gjatë vitit 2025. Në vitin 2026 projektet me financim të huaj janë miratuar në programin për mbështetje për zhvillimin ekonomik, pra AA 122 në vlerën 60 milion e 700 mijë. Të treja këto projekte duhet të pakësohet ky fond dhe të kalojnë në programin për zhvillimin ekonomik vendor. Janë në programin e menaxhimit, planifikimit dhe administrimit dhe duhet të kalojnë në programin për mbështetjen e zhvillimit ekonomik vendor. Projektet me financim të huaj në buxhetin e vitit 2026 janë planifikuar 60 milion e 700 mijë. Këto 3 projekte janë të miratuara dhe duhet të kalojnë sipas programeve të miratuar gjatë vitit 2025 të reflektohen në buxhetin e 2026.

Kryetari i Bashkisë S.filo: Valbona thoja më shkurt, nuk ka ndryshim fondi ka qënë për projektet me financim të huaj dhe thjesht po detajohet tani.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka ndonjë koment lidhur me këtë pikë të rendit të ditës?

Këshilltare A.Përmeti: Na i ka sqaruar edhe herë tjetër ekzekutivi, para se një program të miratohet marrëveshja ne si Këshill Bashkiak i hapim dritën jeshile duke miratuar programin në vetvete. Në momentin që nënshkruhet marrëveshja dhe fondet bëhen efektive ne si Këshill duhet të detajojmë

shpenzimet ku shkojnë ato dhe ato shkojnë për investime dhe shpenzime operative nëse shohim zërat sipas programeve që janë, kjo është pak a shumë t'ju vijë në ndihmë kolegëve.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 7 e rendit të ditës.

“ MBI MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNOJËSVE DHE TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEHDUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE NË INSTITUCIONET E VARËSISË PËR VITIN 2026”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem z.Habip në emër të komisionit të financave.

Këshilltar A.Habip: Komisioni ka sjellë për miratim nivelin e pagave të punojësve të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë për vitin 2026. Niveli i pagave që kërkohet të miratohet vjen si rezultat i indeksimit në masën 2.5 % si dhe politikës të rritjes të pagave. Komisioni në shumicë votash ja kaloi Këshillit për miartim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltare M.Qeleshi: Sipas vendimit të Qeverisë me rirjten 2.5 % të indeksimit të pagave, struktura e buxhetit do të lëvizet në favor të shpenzimeve të personelit. Unë dy shifra do jepja që të ardhurat e planifikuara për tu vjelë nga qytetarët janë rreth 12 miliardë lekë të vjetra, ndërkohë shpenzimet e personelit shkojnë rreth 13 miliardë lekë dhe do duhen për të përballuar këto shpenzime paga për personelin edhe 1 miliardë lekë të vjetra që të relaizohen shpenzimet për personelin. Të gjitha të ardhurat siç e kemi thënë të gjitha të ardhurat siç e kemi thënë edhe në buxhet të marra nga qytetarët do shkojnë për të mbuluar këto shpenzime duke shtuar edhe një vlerë të kosniderueshme. Nëse marrin parasysh edhe realizimin 72 % që është edhe për shpenzimet e personelit të të ardhurave vetjake të taksave dhe tarifave, i bie që mos jetë vlera 1 miliardë por të jetë edhe 3.7 për të përballuar këto shpenzime personlei, domethënë duke qënë se shpenzimet e personelit marrin peshën më të madhe në buxhet, nga rritja e numrit të punojësve dhe indekismi i pagave dhe duke qënë se këto realizohen shumë pak, përsëri buxheti pavarisist strukutrimt shkon në favor të shpenzimeve të personelit të cilat janë të vetmet që realizohen në shifra gati 80-90 % dhe kjo vlerë ze gati gjysmën e shpenzimeve të buxhetit, shifra shumë të rëndësishme që flasin për performancën e Bashkisë vetëm në favor të personelit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, fjala për kryetarin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Dua të jap 2-3 sqarime të vogla për këtë pikë. E para struktura e pagave dhe niveli i pagave nuk përcaktohet vetëm nga propozimi i Administratës të Bashkisë, por ka një vkm e cila rregullon nivelin e pagave të pushtetit vendor me kufirin minimal- maksimal të cilës ne i jemi përmbajtur kur kemi sjellë propozimin këtu për nivelin e pagave të punojësve dhe është i njëjti nivel pagash që është në Bashkitë e tjera sipas kategorisë në të cilën ndahet Bashkitë. Nuk është se Bashkia Korçë ka bërë ndonjë çudi dhe ka vendosur paga jashtë kontrollit nga realiteti i pagave e përcaktuar edhe në VKM-në respektive. Pika e dytë burimet e financimit të pagave nuk kanë qënë historikisht nga burimet e financimit të Bashkisë ju e dini që buxheti i Bashkisë përbëhet nga të ardhurat e veta dhe nga transfertat e pakushtëzuara sektoriale dhe burime të tjera financimi. Fondi i pagave historikisht është përballuar nga një kombinim i transfertës të pakushtëzuar të Qeverisë dhe të ardhurave tona, kjo ka qënë edhe në kohën kur institucioni i Bashkisë përfaqësohej nga forca tjetër politike. Përsa i takon performancës të të ardhurave, ju përmendet një shifër të totalit të të ardhurave që mbledh Bashkia, tani niveli i të ardhurave është i përcaktuar nga dy burime, i pari nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore të cilën e kemi diskutuar dhe e kemi miratuar këtu tek Këshilli i Bashkisë dhe nga performanca e punës të Administratës Tatimore. Drejtoria tatimore e Bashkisë për të mbledhur të ardhura nga baza e individëve apo subjekteve që në bazë të ligjit dhe vendimit të Këshillit duhet të paguajnë këto të ardhura. E kam edhe në mbledhjen e buxhetit, që performanca e drejtorisë të ardhurave e Bashkisë Korçë e vitit të kaluar ka qënë shumë e mirë. Pavarsisht se nuk ka pasur një rritje të nivelit të taksave nga ana e drejtorisë të taksave janë mbledhur mos gaboj rreth 80 milion lekë të reja gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin 2024. Nuk kemi çeduar në mbledhjen e të ardhurave tona, e kundërta është e vertetë. Këto doja të thoja.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, po znj. Qeleshi.

Këshilltari M.Qeleshi: Vendimin e Qeverisë e pashë që në fillim sepse normale nuk mund të bëni indeksim pagash ju pa vendim Qeverie, për të qënë korrekt e thashë që në fillim. Unë bashkinë Korçë shikoj nuk kam pse shoh Bashkitë e tjera. Unë interpretova vlerën absolute të shifrave, pastaj burimet e financimit mund të jenë transfertat por varet emërtimi që mund t'ju vesh. Në vlerë absolute jam korrekt e shifrave që thashë. Përsa i përket realizimit është ajo që pavarsisht se jepni shifra të konsiderueshme të realizimit, po marr më të afërtën në 2025 janë realizuar 72 % por vetëm zëri, taksat nga ndërtesat e reja është realizuar 90 milion nga 280 milion të planfikuar, kjo është shifra që çdon çdo vit kështu që nuk mund të sqaroni performancën, pavarsisht në burimet e financimit, në vlerë absolute shifrat time janë shumë korrekte.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe njëherë për këshilltarët edhe për ju. Niveli i pagave përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, bëre një krahasim ndërmjet fondit të pagave, krahasuar me të ardhurat që Bashkia mbledh vetë, Në lidhje me fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore nuk kemi bërë shpikje, nuk kemi vendosur paga sipas mendjes tonë dhe sipër nivelit të Bashkive të tjera por sipas VKM-së respektive për pushtetin vendor, aq sa e kanë edhe Bashkitë e tjera të kategorisë tonë. Në pjesën e shpenzimeve të ardhurat që kemi mbledhur jo planfikimin, krahasuar faktin, fakti i të ardhurave të mbledhur me 2025 krahasuar me 2024 janë rreth 80 milion lekë të reja të mbledhura më tepër se në 2024, pavarsisht se në 2025 krahasuar me 2024 nuk ka pasur ndryshim të taksave dhe tarifave, këtë thashë, nuk kemi neglizhuar në mbledhjen e të ardhurave.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, kryetar. Hap procesin e votimit, ju lutem këshilltarëve të votojnë.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 3

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 24 pro, 3 kundër, 0 abstenim.

Pika 8 e rendit të ditës.

“ PËR PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA TË BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË NË BUXHETIN E VITIT 2026”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem z.Habip në emër të komisionit të financave.

Këshilltar A.Habip: Ekzkeutivi ka dërguar për miratim përdorimin e të ardhurave për vitin 2025 të Bashkisë. Të ardhurat e trashëguara të vitit 2025 pasi janë rakorduar me degën e thesarit, janë dërguar edhe në Ministrinë e Financave në datën 28 janar 2026, vlera e të ardhurave të trashëguara është 263 milion e 112 mijë e 47 lekë të ndara si më poshtë. Transferta e pakushtëzuar sektoriale 63 milion 109 mijë e 293 lekë, transferta e pakushtëzuar sektoriale e grandit të performancës 878 mijë e 876 lekë, transferta e pakushtëzuar sipas aktit normative 16 milion e 102 mijë e 669, transferta e pakushtëzuar 26 milion e 355 mijë e 34 lekë. Të ardhura nga taska dhe tarifa 155 milion e 571 mijë e 82 lekë si dhe sponsorizimi 1 milion e 75 mijë e 93 lekë. Gjithashtu ekzekutivi ka dërguar të detajuar edhe përdorimin sipas shpenzimeve dhe investimeve për vitin 2026.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje apo diskutime nga këshilltarët?

Këshilltare A.Përmeti: Kam një pyetje për zërin në shpenzime që i kalojnë buxhetit të 2026 në pjesën ku konsiston ndërtimi i zyrës të informacionit turistik që është buxhetuar në një vlerë 10 milion lekë të reja?

Sepse atë ditë në komision nuk morëm përgjigje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Siç edhe u diskutua në mbledhjen e buxhetit për prioritetet e investimeve që parashikohen të ndërtohen gjatë 2026, është dhe ndërtimi i një zyre të re informacioni turistik, tek sheshi i Katedrales në krahë të djathtë parashikojmë të ndërtojmë një zyrë informacioni e cila do krijojë kushte më të përshtatshme dhe komode për punojësit e kësaj zyre por edhe për vizitorët për të marrë informacion sidomos për vizitorët e huaj. Nga pikëpamja e urbanistikë dhe arkitekturës do kompletojmë sheshin, kemi bërë një preventive paraprak të inestimit që duhet për realizimin e kësaj zyre, i cili është në masën 40 milion lekë të reja, të cilin mendojmë ta financojmë në disa burime, së pari do i kërkojmë Këshillit të Qarkut për ndryshimin e një fondi që kishin dhënë për ndërtimin e një muzeu historik për ta kaluar tek ndërtimi i kësaj

zyre dhe për të plotësuar diferencën kemi parashikuar në detajimin e të ardhurave të trashëguara dhe alokmin e një fondi rreth 10 milion lekë të reja mos gaboj nga këto të ardhura të trashëguara.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, znj. Qeleshi ka kërkuar fjalën për koment.

Këshilltari M.Qeleshi: Pas diskutimeve edhe në komision, vlera e të ardhurave të trashëguara rreth 82 % do kalojnë në 2026 për paga, shpenzime korrente dhe investime. Mos përdorimi i të ardhurave të trashëguara tregon edhe kjo një formë dështimi përsa i përket mos përdorimit të tyre në vitin aktual dhe tregon se qytetarët nuk kanë marrë shërbimin shpenzime korrente dhe investime. Vihet re një fenomen në vitin 2022 fondet e trashëguara kanë qënë rreth 191 milion, sot janë 263 milion kanë një rritje rreth 72 milion lekë të reja që tregon se vlera e fondeve të pa përdorura nga vit në vit është në rritje dhe rritja e mos përdorimit të fondeve është tregues dështimi për Bashkinë, pavarisht strukturimit të % të zërave të buxhetit me këtë lëvizje dhe përdorimin e të ardhurave të trashëguara. Përsëri investimet nuk shkojnë më shumë se 20 % të planifikuara se realizimi pastaj nëse shohim edhe 2025 është 16 %, pavarisht se të ardhurat e fondeve trashëgohen % që zenë fondet e trashëguara plus shpenzimet e buxhetit nuk shkojnë më shumë se 20 % që është tregues i vlerës sesa shërbime ju jepen qytetarëve ose sa ata paguajnë për të marrë investim që është tregues zhvillimi.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, fjala për z.Petri.

Këshilltari L.Petri: Një pyetje në lidhje me pikën që e ceku edhe kolegja Përmeti dhe nga përgjigjia që dha z.Kryetar, dua të di në lidhje me zyrën e infomacionit sepse edhe në mbledhjen e kaluar edhe në mbledhjet e tjera, madje dhe unë kam pyetur dhe kam marrë informacionin që zyra do jetë te Kulla. Tani zyra tek Kulla nuk do jetë më, do jetë edhe kjo e Kullës edhe në Katedralja?

Pyetja e dytë lidhet me projektimin dhe me këtë prevetivt që na u tha 40 milion lekë të reja, është projekt propozimi që ka erdhur nga kush, apo është bërë thirrje me arkitektë të tjerë apo me arkitektë që keni në Administratë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në lidhje me pyetjet dhe konstatimet që u bënë nga znj.Qeleshi ka disa arsye sepse në fund çdo viti ne kalojmë në vitin tjetër të ardhurat e trashëguar, pjesë e madhe e këtyre fondeve janë në vonesa të ndryshme të ardhjes të faturave për shpenzimet operative apo të investimeve. Mund të jenë shpenzime operative apo investime që janë realizuar gjatë vitit 2025 për shkak të mos ardhjes të faturave janë kaluar në vitin 2026 dhe do paguhen gjatë këtij viti. Një pjesë e këtyre të ardhurave lidhet me pamundësinë për arsye objektive kryesisht për realizimin e disa prej investimeve të parashikuara dhe prandaj një pjesë e konsiderueshme e këtyre të ardhurave të trashëguara do përdoren për investime, po ta shihni atë detajimin një pjesë e madhe janë lenë për infrastrukturë rrugore, kryesisht në pjesën rurale në fshatrat e Bashkisë Korçë siç e kemi thënë ato pjesë të territorit të Bashkisë që kanë më shumë nevojë dhe besoj të kemi më shumë zhvillime në pjesën e infrastrukturës. Për detajime në shifra në vlera të flasë Valbona pastaj. Në lidhje me pyetjet për zyrën e informacionit turistik nuk e di se çfarë ka pasur konfuzion por po e sqaroj edhe njëherë, ne kemi aktualisht një zyrë informacioni turistik e cila është tek Sheshi i Kullës por është në dimensione dhe përmasa të vogla dhe e kemi gjykuar se nuk është e përshtatshme dhe nuk ka komoditetin e duhur që duhet të ketë zyra e turizmit e Bashkisë Korçë, prandaj kemi menduar

ndërtimin e kësaj zyre e cila do jetë shumë e madhe, mos gaboj Çimi në total rreth 350 M2, zyra e vjetër edhe ajo do jetë në funksion, mbase në funksion të turizmit nuk e di, nuk e kemi diskutuar por jemi në process vendimmarrje, mund të jetë një pikë ku mund të jepen biçikleta me qira për vizitorë të huaj. Sa i takon projekti koncepti fillestar është hartuar nga Pjetër Willson, ndërkohë që detajimi është bërë nga zyra e urbanistikës e Bashkisë Korçë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Znj.Qeleshi, ju lutem përmblihdhini në 1, se ju nuk do ju jepni përgjigje fjalëve të kryetarit.

Këshilltare M.Qeleshi: Jo një sqarim për komentin që bëri.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ai ka për detyrë t'ja u sqarojë njëherë, ju keni të drejtë të bëni komente, diskutime si këshilltarë por komenti mbi komente nuk bëhen.

Këshilltare M.Qeleshi: Të drejtën e 2-minutshit e kam unë?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Po ja u dhashë.

Këshilltare M.Qeleshi: Është replika ndaj kryetarit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Po e keni bërë 3 herë, meqenës ja u dhashë fjalën vazhdoni.

Këshilltare M.Qeleshi: Kryetar, një nga pikat që unë mëshova ishte që nga viti në vit i mos përdorimit të fondeve të trashëguara, përgjigje nuk më dhatë për të. Arsyet pse nuk janë përdorur na i sqaroi Bona në komision dhe janë shumë të qartë, por problem është që ju sa vini dhe gjithmonë nuk i keni përdorur fondet janë vetëm në rritje. Këtë pyetje unë nuk e mora nga ju.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, z.kryetar fjala për ju.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në pjesë e të ardhurave vijnë nga mos përdorimi i fondit të pagave. Keni ndonjë problem ju që nuk është përdorur fondi i pagave?

Ju atje e keni theksnin gjithmonë, qëkur filloi mbledhja atje e ke mendjen dhe unë ndaj e fillova nga pagat. Mos më oriento mua nga dua ta filloj unë sqarimin tim, një pjesë e kursimeve vjen nga nga kursimi i fondit të pagave, 10-20 % janë kursyer nga ky fond. Këtë trendin e të ardhurave të trashëguara mund ta shpjegojë Valbona, për mua ka rëndësi që këto të ardhura të përdoren sipas një destinacioni të duhur dhe një pjesë e tyre do përdoren për infrastrukturën.

Këshilltare M.Qeleshi: Edhe pas këtij strukturimi të 77 % të fondeve të trashëguara nuk shkon më shumë se 20 % në totalin e buxhetit të 2026, kjo është e rëndësishme 20 % jo 77 që trashëgohet.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Unë do doja që, meqenëse jeni të sqaruar mirë prandaj bëhen mbledhjet e komisioneve, prandaj dhe ekzekutivi është present tek mbledhja e komisionit që gjitha këto pika teknike të diskutoheshin. Fjalën e ka z. Koçibelli.

Këshilltar K.Koçibelli: Kisha dy pyetje. Nga fjala e kryetarit përmendi Muzeun Etnografik që ne e kemi miratuar dhe kemi votuar me dëshirën më të madhe për të pasur një muze dhe shoh që të ardhurat mesa kuptova nuk do investohet tek ai Muze. Pyetja e dytë me shumë interes për të pasur një zyrë informacioni jo vetëm për të dhënë informacion por edhe për të pasur një bashkëpunim

me subjektet në Qarkun e Korçës dhe pse jo guidatorët e rinj të kenë një bashkëpunimi sesi mund të hasin ata klientet e rinj ose turistët që kërkojnë shërbime të ndryshme por të marri edhe informacion sesi mund të investojnë në të ardhmen në qytetin e Korçës. Këto ishin ato.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, fjala për z.kryetar dhe më pas znj. Ada, të ruajmë balancë. Kemi hapur fjalën për komente.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në Lidhje me Muzeun Etnografik unë vazhdoj ta gjykoj se është shumë i rëndësishëm për ruatjen e historisë të qytetit të Korçës por edhe si një projekt në funksion të turizmit, duke zhvilluar një pikë tjetër të vizitueshme. Problemi qëndron se kemi planifikuar muzeu të vendosej tek godina e shtëpisë ajo e Flamurit por ndërkohë jemi vonuar shumë me zbatimin e projektit sepse ajo godina është në pronësi të Ministrisë të Kulturës dhe nuk kemi mundur të kordinohemi dhe t'i hapim rrugë këtij investimi. Për mos vonuar përdorimin e këtij fondi të destinuar që në fund të 2024, kam menduar ta kalojmë tek ky destinacion i ri. Vëmendjen për Muzeun Etnografik do e kemi dhe në momentin që do kordinohemi me Ministrinë për zbatimin e këtij projekti pastaj do shohim mundësinë e financimit, nuk kam hequr dorë thjesht nuk dua të vonoj më tepër përdorimin e këtij fondit. Përsa i përket zyrës të informacionit është shumë e drejtë ajo që tha Kristi, jemi duke punuar me disa projekte në fushën e turizmit, disa janë investime, disa janë masa soft dhe një prej këtyre masave është që ne po bashkëpunojmë me disa partnerë, organizata për të krijuar atë që është organizata e menaxhimit turistike. Do bëjmë bashkë edhe aktorë të shoqërisë civile, operatorë në fushën e turizmit dhe këdo që ka një interes për të dhënë një kontribut në fushën e turizmit dhe zyra mund ta luajë edhe këtë pikë takimi me këto organizata dhe zyra krijon kushte për transferimin e sektorit të turizmit, sepse me përfundimin e zyrës dhe sektori i turizmit do vendoset tek kjo zyrë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, fjala për znj.Përmeti, më pas z.Pllaha.

Këshilltari A.Përmeti: Në lidhje me materialin për të ardhurat e trashëguara nga viti 2025 në vitin 2026, mund të jetë edhe për shkak të performancës, nëse ne shohim se nga vjen ky fond shohim se pjesa më e madhe vjen nga fondi social, nga grantet të marra nga fondi i vitit 2025 por gjithashtu lidhet me disa fatura të marra nga disa investime që pavarsisht se janë realizuar në 2025 nuk mund të shlyhen brenda këtij viti. Ajo që është e rëndësishme për mua si këshilltar është shoh që Bashkia me performancën e të ardhurave të saj është në rritje dhe kjo bën që të realizojë më shumë investime. Buxheti i trashëguar ndahet në 77.9 % do jenë investime dhe kjo është diçka pozitive, 13 % janë shpenzime operative dhe 9.1 është shpenzime personeli. E gjithë kjo është efekt sidomos i pages minimale, ata punojës të cilët kanë paga të ulëta ju rritet paga me 5 apo 10 mijë dhe kjo do të thotë që ata kanë më shumë mundësi për të përballuar standartin e jetesës, pjesa tjetër e pagave të larta është thjesht indeksimi 2.5 % që është dhe inflacioni sipas bankës të Shqipërisë. Gjë tjetër që vlerësoj është dhe pjesa e kujdesit që një pjesë e fondeve shkon për mirëmbajtjen dhe rikonstrukcionin e zyrave të njësive administrative të cilat ne si Këshill Bashkiak gjatë takimeve që kemi bërë i kemi ngritur si shqetësim dhe kjo ofron shërbim më të mirë për qytetarët. Para se t shohim këto duhet të shohim edhe anët pozitive sesi ndikon kjo në jetën dhe mirëqënien e qytetarëve.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, fjala për z.Pllaha.

Këshilltar k.Pllaha: Meqënëse u hap si diskutim kam vetëm një koment për zyrën e turizmit, mendoj se është diçka që duhet bërë, por në mendim personal besoj se Bashkia ka mjaftueshëm hapësira për të ndërtuar këtë zyrë dikur tjetër ose nëse krijohet në qendër të Katedrales megjithë respektin që kam për zyrën e urbanistikës mendoj se nuk duhet të jetë një vendim i vetëm i tyre po duhet një konsultim i gjërë publiksepse janë ndryshime që bëhen në bërthamën e qytetit dhe kanë një ndikim të madh në urbanistikën e këtij qytet, faleminderit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit. Hap procesin e votimit, ju lutem këshilltarëve të votojnë.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 20

Vota KUNDËR 6

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 20 pro, 6 kundër, 1 abstenim.

Pika 9 e rendit të ditës.

“ PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME QIRA TË PASURISË 505 M2, PASURI E LLOJIT TRUALL, PASUR ME NR 2/353 ZK. 85/ 63 PËR QËLLIME BIZNESI”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem, komisioni.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare për procedurë, megjithë respektin për z.Nexhip, shoh se emri i zotërisë, ai qoftë mire atje ku është por çdo emër i zotërisë këtu tek anëtarët e komisionit kur ne e dimë që ai nuk është më pjesë e grupit. Kur do përditësohen emrat ju lutem?

E vë re që dhe tek dërgesat që bëni me email është edhe z.Nexhip, nuk e di nëse është detyrim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem, këtë shqetësim kemi dhe ne dhe sekretariati dhe deri në momentin që z.Nexhipi nuk ka shprehur dorëheqjen e tij jemi të detyruar të zbatojmë afatet ligjore, Brenda 6 muajve nëse nuk paraqitet automatikisht Këshilli merr vendimin për ta shkarkuar. Jemi duke pritur, kjo është mbledhja e 5 e Këshillit ku ai nuk merr pjesë, do presim edhe muajin prill, në të kundërt do kërkojmë vendimmarrjen Këshillit. Në lidhje me pikën e rendit të ditës do flasë dikush. Kristi si jurist?

Atëherë drejtorja juridike.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Bëhet fjalë për fillimin e procedurave të dhënies me qira të një pasurie e cila ndodhet në afërsi të varrezave të qytetit, sipërfaqja e cila do jepet me qira është 205 M2 dhe afati që propozojmë dhënien me qira është 1 vit dhe tarifa mujore është 100 lekë për M2 në muaj. Zëri kadastral është shesh, e kemi bërë pothuajseçdo vit si procedurë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje?

Këshilltar K.Pllaha: Meqënëse e kemi bërë çdo vit qiramarrëse ka qënë i rregullt, e ka marë e ka rinovuar çdo vit, pse nuk e japim me afat më të gjatë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kështu është gjykuar me idenë që mund të na lindë për një investim tonin dhe mos e angazhojmë për periudha afatgjata, aq më tepër ku në dijenin time nuk është se në këto hapësira është bërë ndonjë investim që kërkoj detyrimisht një kontratë afatgjatë për të siguruar për të siguruar shërbimin e investimit, kështu është gjykuar.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje apo diskutime?

Nëse jo e hedhim në votim, ju lutem këshilltarëve të kujdesshëm të votojnë në kohë.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 26 pro, 1 kundër, 1 abstenim.

Pika 10 e rendit të ditës.

“ PËR NDRYSHIMIN E LLOJIT TË TRANSFERIMIT NGA PËRDORIMI NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË TË TOKAVE QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUQËSISË DHE USHQIMIT (TOKA PRODUKTIVE) SI DHE TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË PASURIVE QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE ADMINISTRATIVE DHE USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Meqënëse komisioni nuk u mbledh një sqarim nga ekzekutivi dhe nëse më pas nëse ka pyetje apo koment nga këshilltarët.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Që nga hyrja në fuqi e ligjit 20 të vitit 2020 jemi në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit dhe përditësimit të listës të inventarit të pronave dhe rregjistrimit të tyre pranë ASHK-së dhe përmirësimi konsiston si në listen e inventarit të Bashkisë ashtu edhe në ato të trashëguara nga njësitë administrative. Në këtë material kemi paraqitur disa zëra në disa njësi njësi administrative, ndryshimin e llojit të transferimit e kemi kërkuar në tokat buqësore të cilat na kanë kaluar thjesht në përdorim dhe jo në pronësi dhe kërkojmë që të na transferohen në pronësi dhe këto janë në njësinë administrative Mollaj dhe Drenovë. Në qytetin e Korçës kemi kërkuar dy pasuri objekte të na transferohen në pronësi, bëhet fjalë për një objekt që ndodhet tek kopështi nr.7 dhe tek ish- ndërtoja na ka kaluar në pronësi trualli por nuk na ka kaluar një ndërtesë që ndodhet tek ky truall.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje?

Këshilltar K.Pllaha: Në material dëgjova disa herë një shprehje që thotë në kuadër të investimeve që Bashkia Korçë ka për qëllim të realizojë tek këto pasuri. Mund të na i specifikoni nëse nuk është sekret, çfarë ka ndërmend të investojë Bashkia tek këto prona?

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: (Nuk ka audio, flet pa mikrofoni.)

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje apo diskutime?

Nëse jo e hedhim në votim, ju lutem këshilltarëve të votojnë.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 26 pro, 1 kundër, 1 abstenim.

Pika 11 e rendit të ditës.

“ PËR MIRATIMIN E STEMËS “LOGO” QËNDRA E SHËRBIMEVE PËR MBËSHTETJEN E FËMIJËS DHE FAMILJES NË KORÇË.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Një sqarim nga ekzekutivi.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Me urdhërin e kryeministrit 168 të vitit 2025 është miratuar struktura dhe organika e shërbimit social-shtetëror dhe është bërë një ndryshim i tipologjisë të shërbimit dhe në përmbajtje të vendimit gjithashtu rezultoi edhe ndryshimi i emërimit Shtëpa e Foshnjës “Lulet e Vogla” në emërimin shërbimi mbështetës për familjen. Në këto kushte lind nevoja të ndryshohet stema, logoja dhe vula e këtij institucioni.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje apo diskutime?

Këshilltar L.Petri: Kisha një propozim znj.kryetare sepse u diskutua edhe herën e parë për 1 logo Qyteti i Sportit dhe kisha një propozim që bashkia mund ta konsiderojë kur ka nevojë për dizjeni logosh, mund të bashkëveprojë punën me student- nxënës ta bëjë si thirrje ose dhe me Tefta Tashko Koçon sepse në këtë mënyrë bëhet një gjithëpërfshirje se çfarë po ndodh, kaq e kisha.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit në të ardhmen mbase në çështje të tjera logosh, mund të merret vëmendja e ekzekutivit. E hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 12 e rendit të ditës.

“ PËR MIRATIMIN HAPJE DRITË NË PRONËSI SHTET DHE AKSES NË RRUGË.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Një sqarim nga ekzekutivi.

Drejtoria e Urbanistikës N.Hoxha: Po bëj një sqarim lidhur me materialin. Referuar kërkesës të z.Roland Bilbilin në cilësi të pronarit të pasurisë nr.5 10/ 63 e ndodhur në zk 85/63 në rrugën “Ismail Atifllari”. Objekti i kërkesës është hapje drite në drejtim të pronës shtet dhe krijimi i aksesit në rrugë, sepse objekti ka një rip shtet që nuk lejon të dalë në rrugë. Pasi është bërë vlerësimi nga Drejtoria e Urbanistikës është konstatuar se nuk rezulton të cënohet interesi publik apo dëmtohet prona shtet. Aksesit shërben për përmirësimin më të mirë të pasurisë. I është propozuar Këshillit për miratimin e hapje drite dhe akses në rrugë, faleminderit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje?

Këshilltar K.Pllaha: Më shumë e kam për procedurë, sa herë që një qytetar kërkon hapje drite dhe akses në rrugë, sillen në Këshill apo bëhet njëherë selektim nga ana e urbanistikës që këto janë të pranueshme nga ana e urbanistikës sillen në Këshill dhe ato që nuk shikohen të arsyeshme mos sillen?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Si rregull i përgjithshëm është mos pengohen qytetarët sa kohë që kërkesa e tyre nuk i shkakton dëm interesit publik, kaq. Po të ketë ndikime në interes publik kërkesa filtrohen edhe nuk aprovohen, në rast se nuk ka dëm në interes publik kërkesat miratohen.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër, hap procesin e votimit. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 26 pro, 1 kundër, 0 abstenim.

Pika 13 e rendit të ditës.

“ PËR MIRATIMIN SERVITUT KALIMI NË PRONËN SHTET”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Një sqarim nga ekzekutivi.

Drejtoria e Urbanistikës N.Hoxha: E njëjta situatë pak a shumë, kemi një kërkesë të paraqitur nga shtetasi Olgert Shkëmbi dhe Erjon Shkëmbi në cilësinë e pronarit 499/1, 499/12, para pronës të tyre kanë një pasuri shtet 499/11. Pasi është bërë vlerësimi nga drejtoria e urbanistikës është konstatuar se në servituti i paraqitet i nevojshëm për akses normal për pasurinë 499/10 dhe pasurinë 499/12 është e domosdoshme për ndërhyrjen në objektin ekzistues të amortizuar dhe nuk rezulton të rrezikohet funksioni i pronës shtet, për këtë arsye i kemi kërkuar Këshillit miratimin.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Po z.Pllaha, përsëri keni diçka të pa qartë?

Këshilltar K.Pllaha: Bëj gabim që pyes znj.Kryetare?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Jo bën shumë mirë unë prandaj po ja u jap fjalën.

Këshilltar K.Pllaha: Dua të njihem me procedurat, në një rast të ngjashëm, në rast se një qytetar kërkon kalim servituti në pronë dhe ajo pronë nga ana e Bashkisë nuk është përdorur, mund të lindë e drejta që procedurialisht ta privatizojnë?

Drejtorja e Urbanistikës N.Hoxha: Jo nuk e privatizojmë dot.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Meqënëse kemi Kristin jurist dhe i di më mirë procedurat, po ja jap fjalën atij.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Janë specifikuar rastet kur ju lind e drejta e privatizimit që konsistojnë objekte.

Këshilltar K.Koçibelli: Klajdi e kishte fjalën me përfitimin e pronësisë me anë të parashkrimit.

Këshilltar K.Pllaha: Jo nuk e kisha në anën e parashkrimit, atij i duhet për të pasur akses në rrugë, të shikojë blerjen nga ana e Bashkisë, po pyes lejohet si procedurë apo jo?

Këshilltar K.Koçibelli: Kodi ka parashikuar servitutin, ka 3 lloje, me ligj, me veprim juridic ose me vendim gjykate, në rastin konkret është me ligj ne si Këshill Bashkiak i vendosim barrë një prone , pra servituti është barrë në favor të dikujt. Servituti është gjithmonë kundërshtëpërblim, në rastin konkret nuk ishte me pagesë, është rast përjashtimor besoj.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Jo, (nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar K.Koçibelli: Ka raste përjashtimore kur servituti nuk e rëndon pronën edhe ti bën një përjashtim në pjesa e kundërshtëpërblimit, por me anë të servitutit nuk mund të bëhesh në asnjë moment pronar i pasurisë, pavarishtë çdolloj sjellje që ke mbi atë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit Kristi, besoj se këshilltarët janë sqaruar. Hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 25 pro, 1 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Pika e 14 e rendit të ditës Raport Monitorimit Janar-Dhjetor 2025 ju është shpërndarë gjithë këshilltarëve. Informacion në lidhje me aktetë NSHMAC materiale jashtë përdorimit edhe kjo ju është shpërndarë këshilltarëve. Informacion për nxjerrjen jashtë përdorimit të akteve të llogarisë 31, inventari i llogarisë 24 pajisje, instrumente, vegla pune, llogaritjes 218 inventari i ekonomise dhe llogarisë 215 mjetet e transportit të NSHP-së Korçë. Kalojmë në pika të ndryshme.

Këshilltare M.Qeleshi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Është informacion, nëse ka diçka, ishit të lirë të flisnit me ekzekutivin edhe më parë. Të fitojmë kohë sepse kemi dhe qytetarë që na presin. Informohet Këshilli Bashkiak, nuk diskutohen.

Këshilltare M.Qeleshi: Ke të drejtën e diskutimit znj.Ana.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mbase ju znj.Mirela keni erdhur tani.

Këshilltare M.Qeleshi: Jo kam lexuar ligjin që mund të diskutohet për këto raporte, gjithsesi mos e jepni fjalën sërish. Perderisa ti e sjell këtu dhe është realizimi i 2025 duhet të diskutohet sepse ky material ndoshta është për Ministrinë e Financave dhe ka shifrat.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju e keni përgatitur me shkrim diskutimin lidhur me këtë pikë?

Këshilltare M.Qeleshi: Jo të diskutojmë pastaj me shkrim apo me gojë është gjë tjetër.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Jo e kam fjalën që e keni përgatitur për ekzekutivin.

Këshilltare M.Qeleshi: Me lind e drejta e diskutimit, pastaj është gjë tjetër.

Drejtorja e Financës V.Ziko: Edhe mund të diskutosh nuk ka ndonjë gjë por ky është një raport që tregon treguesit e performancës dhe arritjet e objektivave dhe Këshilli informohet për të, kurse raporti i konsoliduar që miratohet dhe diskutohet në maj është analiza-ekonomiko financiare që atje mund të ketë pyetje apo diskutime. Kjo është thjesht raporti i monitorimit sipas treguesve të performancës, ku bëhet paraqitja sipas programeve dhe për çdo program bëhet paraqitja sipas produkteve dhe çfarë tregues janë arritur gjatë realizimit të vitit 2025.

Këshilltare M.Qeleshi: Domethënë kjo është vetëm për të plotësuar kalendarin apo procedurën, më fal që duhet të informohet.

Drejtorja e Financës V.Ziko: Analizë e thelluar është raporti i konsoliduar që edhe e miratoni në Këshill.

Këshilltare M.Qeleshi: Që e kemi në maj këtë e di por që raporti i monitorimit do diskutime sepse pavarisht se ti e përdor për procedurë, ajo është informacion. Po flas me kryetaren që ka të drejtën e dhënies, nuk e ke ti, po flas parimisht për ty.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare e shoh me vend që nëse kolegët kanë diçka t'ju jepet e drejta e fjalës ndonse është informacion.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Jam dakortësuar mos ndalemi tek teknika financiare atë që tha edhe Valbona. Kalojmë tek ankesa-kërkesa të qytetarëve, meqënëse janë qytetarët dhe po presin e lemë pikat e ndryshme më pas për diskutime. Znj.Rabian Dyli ka erdhur me një problematikë, është çështje që e kemi diskutuar disa herë dhe kemi thënë se do ngrihet një rregullore. Po ja jap fjalën Edës se çfarë është bërë deri tani.

Këshilltare E.Mitre: Në bazë të atyre që tha kryetari dhe në bazë të asaj që vendosëm ne si Këshill, Drejtorja e Strehimit së bashku me Drejtorinë Juridike krijuan një kalendar dhe ne filluam zbatimin e këtij kalendari, kemi bërë takimin e parë ku kemi caktuar pikat për hartimin e kësaj rregullore,

ishin mbledhur gjithë anëtarët e komisionit dhe ne e kishim lënë për nesër për të shprehur propozimet tona çfarë kemi nxjerrë, por meqënëse znj. Mirela drejtoresha ka probleme shëndetësore e lamë në datën 4 mars me propozimet konkrete nga gjithë anëtarët.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka qytetarë të tjerë që ndodhen atje lart, nuk ka erdhur kërkesë me shkrim, meqënëse janë prezent mund të trajtojnë si çështe.

Qyetatr: Quhem Fatmir Dervishi kam erdhur pasi kam një kërkesë për rrugën që nga Ushtria deri tek Shtëpia e Ragamit, kemi bërë disa herë të tjera kërkesa, na është dhënë një përgjigje që do bëhet dhe nuk është bërë asgjë. Ka ndonjë plan Bashkia për të investuar tek ajo rrugë, nëse ka të na thotë. Ajo është kthyher në rrugë plehrash me ato ndërtimet që janë bërë atje. Nëse keni ndonjë përgjigje, që ajo rrugë të jetë funksionale, faleminderit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z.Kryetar nëse ka diçka.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Përshëndetje Fatmir, bashke e kemi diskutuar rikonstruksionin e kësaj rruge që lidh Barçin me pjesën e qytetit të Korçës, nuk me mungon dëshira për të investuar por është çështje e mundësive që kemi. Ne jemi tani në fazën që po finalizojmë hartimin e projekteve për investimet që do kryhen gjatë vitit 2026 dhe lista është realizuar mbi bazën e atyre që kemi marrë nga kërkesat e banorëve të buxhetimit me pjesëmarrje dhe kemi vlerësuar me Administratorët dhe Administratën e Bashkisë për nevojat të ndërhyrjes në territory. Lista e kërkesave është shumë e madhe nga mundësitë që kemi. Në Barç do realizojmë investime në drejtim të asfaltimit të rrugëve, nuk ta them dot në këto momente se cilat rrugë, por do e shohim dhe mundësinë e kësaj rruge. Në rast se nuk kemi mundësi për të bërë asfaltimin do kujdesemi për të bërë mirëmbajtjen periodike të saj, me çakull.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Po z.Petri.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare unë solidarizohem me problemin që ngre z. Fatmir dhe nuk mendoj se është vetëm në dobi të dinjitetit të banorëve atje por është një lidhëse fare hapur me Korçën, por Barçi konsiderohet si lagje e Korçës dhe për më tepër krijohet një paradoks shumë i madh kur shikon vilat e Belvederes qe theksin se thua a ka një lluks gjigandez, ndërkohë që është plot me plehra urbane dhe gropa të mëdha të rrugëve që edhe për turizmin nuk ka hije fare, sepse vizitori qoftë vendas apo i huaj që nga Kisha e “Shën Ilias” do dojë të ecë në vargmalet e Moravës dhe do shtoja edhe që Bashkia në momentin më të parë të shtonte vëmendjen.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Lazjon mendoj se të gjithë ndajmë të njëjtin mendim edhe z.kryetar atë tha.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal tani, po e them edhe njëherë sepse dëgjova vetëm një pjesë të fjalës time, kur fjala ime ishte shumë e gjatë. Thashë se lista e kërkesave është shumë e gjatë dhe nevojave sipas këndvështirmve tona është shumë e madhe për mundësitë që kemi. Në Barç patjetër që do realizojmë një investim dhe po të pyesësh banorët e Barçët kanë priorite të ndryshme, nuk është ky prioriteti i unifikuar do e kishim më të lehtë, në rast se pjesa më e madhe e banorëve të fshatit do vinin dhe do theshin se kjo rrugë është prioritet do e bëja, kam marrë edhe kërkesa të tjera dhe jemi në proces vlerësimi. Unë kam një pyetje në rast se unë bëj një investim në Barç, banorët kë do kishin prioritare. Tani jemi duke parë dhe duke hartuar prevetivat e punimeve që

kemi marrë si kërkesa dhe nevoja dhe situata do jetë pak dinamike, do na duhet të bëjmë një shpërndarje të forcave, e kam parasysh, nuk është kërkesë luksi qëndron si kërkesë por duhet vënë në raport edhe me nevojat e tjera që ka fshati. Po të ishte mundësia do bëheshin të gjitha.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z.Bregu ka kërkuar fjalën.

Këshilltar E.Bregu: Meqënëse jemi duke diskutuar për fshatin Barç, dua t'i sjell në vëmendje kryetarit që atje ka qënë një vend hedhje mbeturinash rrëzë malit, por gjatë hedhjes të mbeturinave është keqpërdorur gjithë zona dhe shumë mbeturina janë hedhur në toka private. Ndoshta dhe kryetari mund të jetë në dijeni dhe në këtë rast vë re se Bashkia Korçë nuk e ka monitoruar procesin e hedhjes të mbeturinave gjë që e ka pasur për detyrë kur ka përcaktuar vendin ku do hidheshin mbeturinat por kjo nuk është kryer. Pasi banorët janë ankuar nuk është marrë asnjë masë dhe tani jemi në një situatë emergjente, ku ata mbase nuk kanë fuqinë por janë në kushte ku duan të padisin Bashkinë për dëmin e shkaktuar, ndaj mendoj se kryetari duhet ta marrë konsideratë dhe të marrë masa urgjente për rikthimin në indetitet të tokave të dëmtuara të fshatarëve të fshatit Barç, faleminderit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po jam në dijeni të kësaj problematike kam kontaktuar një nga pronarët e sipërfaqes të tokës që ishte në emigracion mos gaboj. Ideja është që në afërsi të kësaj prone atje ka qënë një pikë ku depozitoheshin mbetjet inerte por autorizimi i Bashkisë nuk ka qënë për tokat private, nuk i kemi autorizuar ne këto zotëruesit e inerteve që t'i hidhnin në tokat e zotërisë. Kjo gjë ka ndodhur në harkun e shumë viteve dhe ka qënë logjikisht mendoj unë detyrimi i pronarit të tokës që të ruajë pronën e tij sepse nuk mund të ruajë Bashkia se çfarë ndodh në tokat private. Nëse do kishim një informacion të hershëm do kishim bërë një reagim të hershëm. Nuk mund t'i kërkojmë llogari Bashkisë për veprime që kanë bërë individë të ndryshëm pa asnjë lloj autorizimi nga Bashkia.

Këshilltar E.Bregu: Në fakt në asnjë rast ne nuk kemi akuzuar Bashkinë që ka autorizuar dikë të hedhë mbeturinat në token private. Do ju sqaroj unë pse është përgjegjësia e Bashkisë dhe mund t'i hedhë në gjyq. Pasi është përcaktuar vendndodhja ashtu siç u përcaktua edhe në fshatin Melçan Bashkia u zotua se ne monitorojmë që mbeturinat të hidhen tek vendi i caktuar. Në këtë rast Bashkia nuk e ka monitoruar që këto mbetje të hidhen tek vendi i caktuar dhe tani del kryetari flet në mënyrë të pa përgjegjshme që është e turpshme për një kryetar bashkie të thotë se unë nuk kam përgjegjësi që hidhen aty. Nëse nuk do ishte caktuar vendi i mbetjeve aty, kjo nuk do kishte ndodhur. Ata e kanë caktuar aty sepse janë të pa përgjegjshëm dhe Bashkia nuk ka kryer detyrën. Kjo ju ka shkaktuar një dëm qytetarëve, fermerëve të Bashkisë Korçë që janë në fshatin Barç dhe kjo është përgjegjësi totale e Bashkisë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Po sa informacion ka Bashkia nga këta qytetarë?

Këshilltar E.Bregu: Meqënëse na ndërpreve znj.kryetare, po ta sjell në vëmendje sepse ta thashë. Bashkia ka pasur për detyrë monitorimin se ku po hidhen këto mbetje.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Monitorimi në bazë informacioni.

Këshilltar E.Bregu: Po e ktheni shumë qesharake, ju flisni në mënyrë të pa përgjegjshme por kjo nuk na bën aspak çudi.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Je shumë i çlodhur për të bërë komente të kësaj natyre.

Këshilltar E.Bregu: Jam gjithmonë shumë i çlodhur në kohën e duhur dhe vendin e duhur. Ndërsa ju jeni shumë të çlodhur për të mos mbajtur përgjegjësi tuaja. Nëse nuk keni mundësi t'i mbani ka mënyra të tjera zgjidhje.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit për komentin. Një informacion tjetër për këshilltarët, kërkesë për shkarkimin e kryetarit të fshatit z.Arjan Kreka nga njësia administrative Lekas, Kryetari i fshatit nuk është paraqitur për një periudhë të konsiderueshme kohe sepse është larguar në Greq, fshati ka nevojë për një kryetar sepse lindin problemet he t'ju jepet zgjidhje. Për këtë arsye kërkojmë të merren masa nga ana juaj dhe në fshatin sipas procedurave të bëhen zgjedhje për vendosjen e kryetarit të ri. Ju falenderoj për mirëkuptimin tuaj!

Këtë kërkesë po ja kaloj për njohje edhe komisionit të ligjeve dhe më pas të ndiqen gjitha procedurat për zgjedhjen e kryetarit të ri dhe deri në ato momente lind e drejta e kryetarit të Bashkisë për emërimin dhe zvëndësimin e kryetarit të fshatit Lekas.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Fshati ka një kryesi dhe ajo duhet të mblidhet dhe të bëjë shkarkimin e kryetarit të fshatit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Të nisin procedurat, kjo ishte vetëm informacion. E fundit letër e hapur mbi situatën e shkaktuar nga rreshjet për rrugën Korçë – Tiranë, drejtuar Këshillit të Qarkut Korçë, Këshillit Bashkiak. Të nderuar anëtarë të këshillit, e nderuar Prefekte, i nderuar Kryetar me këtë letër ju shprehim shqetësimin tonë për situatën emergjente e krijuar nga bllokimi i rrugës si pasojë e rëshqitjes, një situatë e cila po shkakton dëme të rënda në qarkullim, ekonomi, siguri publike dhe funksionimin normal të jetesës sociale në territor, gjendja aktuale ka shkaktuar izolim të pjesshëm, vështirësi serioze për biznese dhe transportin. Duke qënë se kjo situatë ka karakter serioz dhe i tejkalon funksionin administrative të zakonshëm, kërkojmë trajtimin me prioritet maksimal institucional. Kërkojmë thirrje për mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit të Qarkut dhe gjithë të zgjedhurve të tjerë pa dallime partiake për zgjidhjen e situatës, shpalljen e gjendjes të emergjencës lokale me përputhje legjislacionin në fuqi , për shpejtimin e procedurave dhe mobilizimin e fondeve të nevojshme. Hartimin dhe publikimin e një plani të qartë ndërhyrjedhe aftatet konkrete realizmi, indetifikimi dhe vënien në dispozicion të fondeve emergjente ose rialokimin për zgjedhjen e përkohshme dhe afatgjatë, kordinimin e me menjëhershme të institucioneve qendrore për infrastrukturën rrugore, kërkesë llogarie për këto insitucione lidhur me afatin e zgjidhjes të këtij problem dhe alternativat për qytetarët e qarkut Korçë. Në konferencën e drejtorëve mbajtur dje u ndërmor masa për qarkullimin e kamioneve, por askush nuk dha alternativa për qytetarët e Qarkut Korçë. Ju kujtoj se kjo problematikë do sjell problematika të rënda ekonomike dhe sociale, duke filluar nga rritja e naftës, rritja e biletës të transportit, një tjetër shqetësim është furnizimi me naftë i rajonit, pasi drejtori i doganave tha se nuk lejoh më kamionet me naftë dhe askush nuk e ngriti si shqetësim. Informim publik dhe transparencë mbi ecurinë aktuale dhe tyre që do bëhen, të ushtrojnë presion institucional qeverisë qendrore. Presim një përgjigje zyrtare brenda afateve ligjore dhe shprehim gatishmërinë për të marrë pjesë në çdo dëgjuesë apo konsultim publik. Me respekt Milion Thanas, Eriseld Kalemaj, Lazjon Petri, Pandi Mitri.

Ka ndonjë pyetje apo koment nga këshilltarët?

Këshilltar I.Bode: Meqëse erdhi kjo situatë dhe unë brenda këtyre kornizave e kisha diskutimin tim, do kërkoja një mirëkuptim nga ju znj.kryetare të bëja një pyetje dhe të ma ri jepni sërish fjalën për diskutim sepse për shkak të përgjigjeve nga ekzekutivi do vijojë diskutimi im.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Këtu jemi në pika të ndryshme dhe ky ishte thjesht për informacion dhe jeni të lirë të bëni pyetje dhe diskutime me njëri-tjetrin, ndërtojeni si të doni.

Këshilltar I.Bode: Të gjithë jemi të vetëdijshëm se çfarë pasoja ka sjellë bllokimi i rrugës. Do doja të dija nga ekzekutivi çfarë është bërë konkretisht prej tyre nga momenti që është bllokuar ai aks dhe deri tani?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar E.Bregu: Tani unë normalisht e kuptoj që nuk janë marrë masa dhe nuk dua të bëj asnjë pyetje por në mbështetje të rezolutës e cila mendoj se është prioritet për zonën e Korçës, jam shumë dakort të hartojmë një rezolutë ta miratojmë në Këshill dhe atje t'i kërkohet Qeverisë se për këta banorë të parashikojnë mbështetje financiare, ndihmë apo shpërblim sepse ky është dëm i caktuar nga Qeveria jo nga kushtet natyrore. Banorët e këtyre rrugëve kanë paguar taksat njësoj si gjithë banorët e Shqipërisë dhe po privohen nga shërbimi që ju takojnë me ligj, për shkak të këtyre ndodhi. Për pjesën e këtyre karburanteve Shqipëria ka një politik e cila nuk lejon hyrjen e tyre nga Maqedonia, nuk e di pse e kanë bërë, e kanë me ligj apo e kanë thjesht udhëzim të brendshëm, drejtoritë e doganave nuk lejojnë, të merren masa urgjente të lejohet qarkullimi për të lehtësuar sado pak përbalimin e këtyre kushteve të vështira.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nuk bere pyetje?

Këshilltar E.Bregu: Jo nuk bëra pyetje sepse e di që nuk është marrë asnjë masë, bëra vetëm propozimin.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z.Kryetar keni diçka në lidhje me pyetjen, pastaj ti japim fjalën z.Bode për diskutime.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Situata e krijuar ditët e fundit nga rëshqitja në segmentin rrugor Prenjas-Librzhd është situatë shumë e vështirë, patjetër kjo situatë ka sjellë problematika që nga lëvizja e njerzve drejt Tiranës e cila po realizohet nëpërmjet akteve alternative e cila po bëhet me një kohëzgjatje më të madhe dhe vështirësi të shtuara. Ka patur edhe efekt mesa kemi parë edhe në fushën e turizmit ka zvogëlim të numrit të vizitorëve, ka anullim në hotele. Ka pasoja në lëvizjen e mallrave të ndryshme, sidomos në varësi të natyrës dhe specifikës që ka malli. E përmbledhur është një situatë shumë e vështirë. Përsa i takon arsyeve, unë e kam si rregull si Kryetar i Bashkisë dhe aq më tepër në mbledhje zyrtare të Këshillit të mbaj një qëndrim institucional në këtë çështje. I kam ndjekur edhe debatet mediatike dhe palët që thonë ka erdhur për shkak të punimeve , edhe reagimin e institucioneve, qajjsja dhe qëndrimi që duhet të kemi është një qasje që qëndron sipas qëndrimit të institucioneve. E para institucionet kanë dijeninë dhe njohuritë për të dhënë përgjigje teknike të verifikueshme dhe e dyta mbajnë përgjegjisë, debati për rrugën mund të bëhet edhe nga njerëz që nuk kanë asnjë lidhje, nuk janë inxhinier ndërtimi dhe të gjithë të japin ato qëndrimet etyre nuk i ndalon njeri. Në një mbledhje zyrtare të Këshillit duhet t'ju besojmë qëndrimit të

institucioneve sepse ato kanë edhe detyrimin ligjor që të mbajnë përgjegjësi për fjalën që thonë, në një kafene apo studio ligjore ai nuk ka asnjë përgjegjësi për fjalën që thotë, mund t'ja futë totalisht kot. Ndërkohë që një institucion ARSH, Hekurudha qëndrimi ynë është ky për 1,2 3 arsye sepse e para kanë edhe kompetenca teknike për gjërat që thonë. Pirja ime është institucionlisht unë ju besoj totalisht institucioneve. Kam patur një konferencë të përbashkët paradisa ditësh nga një sërë përfaqësues institucionesh Policia, Akmc, Shërbimi Gjeologjik, Ministria patjetër, ku është bërë paraqitja e gjendjes. Dje kam patur një komunikim telefonik me drejtorin e ARSH-së pasi ndajmë të njëjtin shqetësim si ju, për efektet negative dhe kam marrë një përgjigje që mesa kam kuptuar është dhënë edhe në rrugë mediatike që ka filluar puna për ndërtimin e një bajpasi të përkohshëm në shtatin e lumit Shkumbin, me një gjatësi rreth 1.3 km, e cila do jetë zgjidhje kalimtare për të siguruar lidhjen midis dy pjesëve të rrugës në sektorin ku ka ndodhur rëshitja dhe drejtori i ARSH-së më ka thënë duhet të presim 4-5 ditë duke filluar nga dje për të na dhënë një përgjigje të saktë dhe ka nevojë për tu bërë një vlerësim për kohëzgjatjen e punimeve. Duhet të presim një periudhë 4 ditore por duhet të jetë në rangun e disa javëve. Kjo është situata e deri tanishme. Përsa i përket asaj pjesës të kërkesës për një presion të shtuar e institucioneve të Bashkisë dhe Qarkut edhe mund të bëhet është e drejta tuaj ta bëni por mendoj se një presion i shtuar ka vlerë në rastin kur ne konstatojmë se nuk ka një reagim nga ana e autoriteteve, më rezulton se nuk është kjo situata, por disa çështje duan edhe kohën e tyre për të bërë studimet për të dhënë një konkluzion të caktuar, unë nuk konstatoj të kemi një problem. Shpresoj të zgjidhet në një kohë sa më të shkurtër janë situata që janë përfshirë edhe vende të tjera, edhe në Greqi edhe Itali ka ndodhur situata të shkarjes. Unë kam parë rast të një qyteze mund ta keni parë edhe ju në rrjetet sociale, gjysma e rrugës kishte shkarë dhe pjesa tjetër ishte e rrezikuar të shkiste, këto situata nuk ndodhin vetëm në Shqipëri por edhe në vende të tjera. Mesa shoh edhe këtë pjesën që e keni me merak, kush e ka përgjegjësinë ligjore, prokuroria e Elbasanit ka filluar edhe një procedim penal për situatën e krijuar, ata do bëjnë procesin e tyre dhe në rast se konstatojnë veprime, mos veprime do marrin masat e tyre, kjo është situata në ndjekje dhe nga komunikimi që kam bërë ditët e fundit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z. Bode më pas z.Bregu.

Këshilltar I.Bode: Këtu po diskutojmë faktin se Juglindjes i është ndërprerë plotësisht arteria kryesore e komunikimit me kryeqytetin dhe me gjithë Shqipërinë , është një rajon i tërë i cili është i detyruar të përdorë një rrugë alternative e cila nuk është aspak e përshtatshme, e cila zgjat edhe udhëtimin mbi një orë dhe kjo nuk është zgjidhje, është bezdi sepse kjo është dhe kosto ekonomie, mungesë sigurie. Pyetja jonë e parë është kur do na hapet rruga dhe çfarë po bëjmë ne si pushtet vendor?

Për t'i ardhur në ndihmë qytetarëve dhe për të zvogëluar efektet aq sa kemi mundësi, të kësaj situatë. Shumica e institucioneve po përqëndrohen në kryeqytet dhe Tirana po kthehet në një qytet-shtet dhe nevojat e qytetarëve për të udhëtuar drejt saj janë më të mëdha. Gjykatat i kemi atje, mjekimin e specializuar e kemi atje, ilaçet vijnë që atje. Gjithashtu kemi dhjetra biznese këtu të cilat e pësojnë goditjen shumë të forte, që nga biznet e prodhimit dhe biznet lokale të shërbimeve. Më shqetësues për mua do ishte mungesa e dhënies të një afati se deri kur do jetë ky bllokim. Se të paktën të kishim një afat do mund të bënim një planifikim si do vazhdohet më tutje. Ne mund të mos jemi institucion i cili menaxhon drejt për drejt këtë situatë por sipas meje mund të bëjmë disa gjëra. Meqënëse në fjalën e tij z.kryetar tha se Bashkia dhe vetë kryetari i saj ajo që ka bërë këto

4 ditë është një bisedë telefonike. Unë kam 1 propozim se si 5 Bashkitë më të prekura të thërrasim një takim të përbashkët ose në nivel Këshillash ose nivel ekzekutivi dhe të dalim me një kërkesë zyrtare publike, drejtuar autoriteteve përgjegjëse për një afat konkret për hapjen e rrugës dhe çfarë inteciteti. Së dyti dhe një bashkëbisedim apo bashkëpunim me bizneset lokale për të kuptuar se deri ku mund të jetë nevoja e tyre që ne t'i lehtësojmë me diçka, me shtyrjen e detyrimeve për këtë periudhë që nuk e di sesa. Këto janë gjëra që mund t'i bëjmë, nuk ka ndonjë gjë pse mos bëhen. Një presion i shtuar siç thotë z.kryetari ndaj institucioneve nuk është se i tremb ata kaq shumë se nuk është se po bëjnë teste bërthamore. Unë mendoj se këto dy pika nuk ka ndonjë gjë, t'i ndërmarrim dhe të bëjmë diçka konkrete lidhje me këtë. Puna është mos rrimë në heshtje dhe mos justifikojmë situatën, të paktën të përkulemi dhe të kërkojmë zgjidhje.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Fjala për kryetarin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po përpiqem ta mirëkuptoj aq sa duhet që çdo situatë fatkeqësie të përdoret politikisht, të paktën mos ver në gojën time gjëra që unë nuk i thashë. Më the se gjatë këtyre katër ditëve ke bërë vetëm një telefonatë, komunikimi i fundit ka ndodhur dje, por komunikimin e kam pasur që kur ka ndodhur situata, ajo ka qënë dinamike dhe ragimet kanë qënë dinamike. Ndodhi problem me urë, dhe atë ditë që u kontaktua problem u tentua të bëhej një bajpas në krahun e shtratit të lumit, u agravua problematika te ura dhe shkarja kapi dhe këtë bajpas që filloi të ndërtohej. Më pas është dhënë krijimi i këtij bajpasi në krahun e lumit. Situata ka qënë dinamike dhe unë nuk thashë u kujtova dje të bëja komunikimin, dje kam bërë komunikimin e fundit. Përsa i takon se çfarë është bërë deri tani, e thashë edhe njëherë ka filluar puna për ndërtimin e këtij bajpasi tek krahu i lumit, pas katër ditësh do kemi një afat. Unë nuk jam inxhinier ndërtimi, jam inxhinier elektronik, ti nuk e di se çfarë shkolle ke bërë je marrë me ndërtime duhet të kesh ndonjë ide. Derisa këta zotërinjtë mbajnë përgjegjësi zyrtare, kanë edhe njohuritë teknike dhe kërkojnë katër ditë për të dhënë datën e saktë, ju nevojiten katër ditë, po bëjnë studime gjeologjike.

Këshilltar I.Bode: Më fal tani se më duket sikur po luani me inteligjencën tonë, gjithë ky fjalim që ju mbajtët më kujton shokun Tare si do bëjmë nga gazetatat, ore si do bëjmë sot?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe ti e fyeve inteligjencën time me ato që the, por numërova deri në 10 thashë e ka politike, do bëjë pak politike partie me fatkeqësinë natyrore ok. Tani duro të mbaroj unë.

Këshilltar I.Bode: Prishja e rrugës është politike z.kreytar, pra ju ju duk sikur e bëra politike?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z.Bode kishit gjithë kohën e mundshme për të folur.

Këshilltar I.Bode: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem tani fjalën e ka kryetari, të mbarojë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mos u bëj qesharak me këto. Sa është volumi i inerteve që duhen zhvendosur për të ndërtuar bajpasin e ri?

Këshilltar I.Bode: Nuk duhet 1.3, ajo 1.3 do deri në tetor mos them them edhe pak më tutje, për të kaluar minimalisht atje makinat e vogla, ambulancat, deri në mjetet e transportit me ngarkesa të

ulta, pra fugonat atje nuk duhet më shumë se tre ditë, e thonë inxhinierët më të mirë që ka sot Shqipëria.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju keni shkuar atje keni matur volume?

Ju lutem dëgjojeni, lëre të mbarojë kryetari ju ju dëgjuam. Pse jeni kaq të çuditshëm doni të impononi patjetër mendimin tuaj, dëgjoni deri në fund.

Këshilltar I.Bode: (Nuka ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mirë vazhdoni flisni dhe mos dëgjoni mendimin. Mirela të lutem mos fol nga vendi, të kemi respektin të zbatojmë rregulloren, të flasë secili çfarë do të thotë, nuk i imponojmë mendimit tuaj, mendimin tonë, ju lutem dëgjoni deri në fund.

Këshilltar E.Bregu: Më falni se dua të ndërhy.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Jo nuk do ndërhy, e ka fjalën kryetari.

Këshilltar E.Bregu: Ne nuk kemi nevojë këtu për propaganda, pyetjet janë të sakta, përgjigjet e sakta.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Atëherë mos ndërhy.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani se e filluam me shumë etikë dhe nuk po ndërprisnim njëri-tjetrin. Më dëgjoni dhe merrni fjalën sërish. Ka një dallim midis përgjigjeve, afateve dhe ndërhyrjeve që planifikon një autoritet që ka edhe përgjegjësi ligjore dhe gjithë pjesës tjetër siç mund të jenë edhe individë këtu në Këshill që e bëjnë diskutimin nga njohuritë që kanë apo kafeneja dhe nuk mbajnë asnjë përgjegjësi dhe dikush thotë e bëj për tre ditë nuk ka kush e merr atë të kërkojë llogari nesër po u zgjatën ditët. Prandaj them që me logjikë ne duhet të shkojmë me qëndrimin e institucioneve dhe nuk besoj se ARSH të japë zgjidhje më të vonuar, ai është një institucion që kur jep përgjigje mban përgjegjësi për fjalët dhe ka thënë se për 4 ditë do japin përgjigje përfundimtare. Për pjesën e dëmeve ekonomike e thashë edhe vetë, e fillova me pasojat e kësaj problematike dhe shpresoj që të bëhet zgjidhja më e shpejtë për të rihapur aksin.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z.Petri, pastaj z.Bregu.

Këshilltar E.Bregu: Pse ma kalove prapë rradhën?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Meqënëse ishte dhe njëri nga hartuesit.

Këshilltar L.Petri: Do ftoja z.kryetar dhe kolegët këshilltarë që sot të jemi në lartësinë e duhur të detyrës dhe le të kemi një qëndrim të unifikuar për këtë çështje mos merremi me ironira e ke politike apo jo, sepse nuk mendoj se kolegu parafolës bëri diçka politike ngriti një shqetësim si kundër dhe z.kryetar ka të drejtë të mbajë qëndrimin që mbajti. Përsa i takon situatës nuk na kushton asgjë që ne ta bëjmë këtë rezolutë quajeni si të doni. Kemi këtu z.Tollkuçi që është kryetar i Qarkut, ka kolegë të tjerë që edhe ata të emëruar në Këshillin e Qarkut, do sygjeroja mos ishte rezolutë tërësisht lokale, tëbihen unison edhe me Këshillat e tjerë Bashkiakë dhe të mbajmë një qëndrim. Z.Kryetar thotë se autoriteti po mban përgjegjësi, por nuk ka mos përgjegjësi më tëmadhe sesa mos lënia e një afat sepse thoni ok me tha 4-5 ditë dhe ju me intuitë honi se do në rangun e disa javëve por në rangun e disa javëve por disa javëve është shumë e paqartë dhe e gjitha kjo qoftë

edhe për efektin simbolik për të unifikuar dhe të mbajtur dinjitetin sepse jemi njerëz të zgjedhur tek këto Këshilla, duhet bërë pastaj Prokuroria bën punën e vet nuk duhet t'i ngatërojmë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z.Kryetar ta dëgjojmë edhe z.Bregu.

Këshilltar E.Bregu: Së bashku nga diskutimet që dëgjova dua t'ju siguroj se askush këtu nuk po bën diskutime politike, ne jemi Këshilli, Kryetari përfaqëson ekzekutivin dhe ne nuk po marrim përgjegjësi kush e ka fajin dhe ne do e ngarkojmë me përgjegjësi dhe do e dënojmë. Ne këtu po diskutojmë për pjesën që na intereson ne, dëmin ekonomik të shkaktuar, pasojat e erdhura nga konëdërprerje. Kryetari kërkon ta quajë fatkeqësi por kjo quhet përgjegjësi, nuk është kjo tema. Tema është pasoja dhe mënyrat e zgjidhjes dhe një nga mënyrat e zgjidhjes ishte lejimi i gjitha doganave pa kufizim të kalojnë mallërat dhe shërbimet që janë në shërbim të banorëve të prekur. E dyta Qeveria e ka për detyrë të dëmshpërblejë banorët për pasojat e ndodhura. Po ndodhi në Greqi ra zjarri ishte totalisht fatkeqësi dhe Qeveria mori përgjegjësi dëmshpërbleu banorët në formë të ndryshme Po i them edhe njëherë kryetarit që mos mbrohet duke thënë politike por të mbajë përgjegjësi. Madje në këtë moment doja të dëgjoja mendimin e intelektualëve të Partisë Socialiste, të merren masa për të dëmshpërblyer këta banorë dhe këtë zonë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Fjala për z.Kryetar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Shqetësimi është shumë i madh, nuk është e vogël situata deri këtu nuk kundërshtoj asgjë, pasojat negative janë që nga lëvishmëria e banorëve, dëmet ekonomike, në problematikat e shkëmbimit të mallrave. Ajo që konsiderova si politike është vënia para përgjegjësisë e autoriteteve pa asnjëlloj kompetence. Ne nuk kemi kompetencë, ne nuk jemi inxhinierë dhe unë vendosa të shkoj pas institucioneve. Të merrja për bazë këshilltarië në këtu që thotë unë e bëja për 3 ditë. Ata të ARSH-së janë budallenj që bëjnë studime, mos e quaj unë politike kur ai thotë po të isha drejtor i ARSH-së e bëja për 3 ditë?

Të përdorim një situatë fatkeqësie për të gjetur fajtorin tek Qeveria, këtë quajta politike, sepse shqetësimi qëndron e kam edhe unë. Tani e rezolutës mund ta bëni por kush është qëllimi?

Të vini institucionet në punë, ato janë vënë, krijuan një bajpas dështoi po krijojnë mundësi të tjera. Më thuaj kush do jetë qëllimi i rezolutës?

Këshilltar E.Bregu: Ne nuk kërkua që rezoluta të përdorej si presion ndaj Qeverisë, ne po ngremë shqetësimet që kanë banorët e Korçës dhe kjo rezolutë do shprehë këto shqetësime për t'i kujtuar edhe njëherë Qeverisë sepse ndoshta dikush ka harruar se ka shqetësime nga situata dhe nuk ka kohë të merret. Ndaj rezolutë do përcaktojë këto shqetësime dhe mendoj se kjo rezolutë të miratohet tek Këshilli Bashkiak jo tek të gjitha Këshillat, nëse miratohet tek gjitha Këshillat do jetë rezolutë Qarku. Unë mendoj çdo Këshill të mbajë përgjegjësinë e tij, e theksoj se këtu nuk po bëjmë presion Qeverisë. Ajo që kërojmë ne është të miratohet rezoluta, me këto pika që të lejohet edhe qarkullimi i mallrave siç ishte përcaktuar edhe në kërkesë që është shumë e vështirë hyrja e karburantit nga Maqedonia por është shumë e rëndësishme.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem mos përsëritni të njëjtat gjëra se nuk jemi në bisedë të lirë. Fjala është hartoni një rezolutë ta firmosim ne.

Këshilltar E.Bregu: Po përsëritim sepse kryetari ishte i pa qartë, ti meqënëse ishte kaq e qartë pse nuk e ndihmove pak?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kryetari ishte shumë i qartë. Do ju lutem gjithë këshilltarëve kur të marrin fjalën për një çështje kaq sensibilizuese mos bini në përsëritje. Thoni mendimi tuaj, nëse ka dakortësi mund të bëni një rezolutë ta miratoni. Mos bëni çdo komentsa herë mendimin kryetari. Nëse ka diçka tjetër ndryshe.

Këshilltar E.Bregu: Unë jam e mendimit që edhe ju si këshilltarë të Partisë Socialiste duhet të mbani dhe ju qëndrimin tuaj.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ti nuk detyron askënd të të japë mendimin ty, secili është i lirë të shprehë mendimin e tij. Znj.Qeleshi.

Këshilltar M.Qeleshi: Sesa sensitive është kjo çështje për banorët e Korçës është shumë e rëndësishme duket nga ikja e këshilltarëve të majtë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Dhe ata që kishin sensibilitetin më të madh ikën.

Këshilltar M.Qeleshi: Pjesa politike u tha nga kryetari u tha para se ai kolegu ynë të jepte zgjidhjet që mendonte. Mos qesh kryetar për këtë problem. Në 2018 keni thënë se do hapet aeroporti i Lumalasit me 200 fluturime ka qënë intervista juaj e largët. Ju lutem pushteti vendor nuk ka shumë në dorë, ju keni detyrë të interesoheni. Arsh-ja, çfarë ndryshon konceptin?

Mja tani se është shumë naive pyetje. Ne si pushtet vendor çfarë kemi zgjidhje, nëse ky aeroport është në funksionim se ndoshta edhe emergjencat, ilaçet mund të bëheshin edhe nga ky aeroport i cili ka vite që është premtuar.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kujdes me ironinë e fjalëve.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Unë mendoj se mbledhja duhet mbyllur sepse nuk kemi as kourum në sallë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Po bëjmë bisedë të lira.

Këshilltar E.Bregu: Nuk po bëjmë biseda të lira, po diskutojmë një problematikë tek pikat e ndryshme dhe kemi dhe çështje të tjera.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nuk kemi kourumin.

Këshilltar E.Bregu: Dhe kjo na pengon ne të ngremë çështjet?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Jo, përderisa jemi këtu.

Këshilltar E.Bregu: Unë hedh poshte propozimin për mbylljen e mbledhjes që dëgjova nga sekretaria e cila është një institucion Këshilli me peshë, nëse për ty nuk vlen fjala e sekretares problemi juaj.

Këshilltar K.Pllaha: Nuk doja ta merrja fjalën por nga diskutimet e bëra këtu, shikoj kryetarin e Bashkisë si spektator ndërkohë që është përrfaqësuesi i banorëve të Korçës. Ajo që kërkohet nga ju, duhet qëndrim instituconal jo si Sotiraq që keni bërë një telefonatë, si Bashkia ja u kërkohet të

mbani qëndrim për këtë gjë, ashti siç ja kërkojmë dhe z.Petrika. E dyta folët për dëmet ekonomike mund të hiqen taksat dhe tarifat vendore për një muaj, mund të bëhet kompensimi i çmimit të biletës, sepse udhëtarët po harxhojnë shumë kohë paguajnë edhe më shumë. E dyta një qëndrim institucional për këtë çështje, kaq.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Këtë fjalën që më sheh si spektator e ke të gabuar se pastaj vjen pyetja tjetër çfarë duhet të kisha bërë konkretisht?

Po të dilja unë dhe të thoja rruga na ka shkaktuar problematika, patjetër që kemi problematika e thashë edhe këtu në Këshill, është zgjatur rruga alternative, pasoja në dëme ekonomike po e them këtu në mbledhje. Tjetra nuk shoh që mos ketë një angazhim nga ana e institucioneve përgjegjëse për dhënie zgjidhje të kësaj situate që ne të bëjmë një rezolutë, institucionet po punojnë 24 orë po do kohën e saj. E treta ju mund të bëni një listë me propozime të masave që mund të marrë Bashkia, për efekt që ka dhe pastaj duhet vlerësuar se cilat nga këto masat janë në dorën e Bashkisë dhe cila jo, kursimi i çmimit të biletave në dijeninë time nuk bëhet nga Bashkia, nga Qeveria po të shohim në dinamikë sa do zgjatë edhe çfarë masa mbështetje mund të ketë. Kryesorja është që situata të vendoset në një afat sa më të shkurtër kohor. Kjo do kërkojë 4 ditë nga dje dhe këtë ma tha drejtori i ARSH-së, që ne të themi afatin përfundmat se kur mbaron ndërhyrja kryesore, nuk e ka lënë të zvarritur. Më ka thënë se i duhen katër ditë për të bërë studimet gjeologjike.

Këshilltar E.Bregu: Kisha diçka lidhur me qarkullimin e makinave dhe parkimet. Siç e dimë qarkullimi në qytet është shumë i rënduar sa makinat ecin të gjitha me marsh të parë dhe kjo është një situatë e papranushme, mund ta pranojmë për festa kur vijnë emigrantët, por kjo situatë ka 6 muaj a më shumë dhe kjo do të thotë që nevojitet ndërhyrja e Bashkisë dhe të marrë masa sa më shpejt që kjo gjendje të normalizohet. Në lidhje me këtë vë re dhe diçka tjetër që nëpër lagje nuk ka shenja të sakta të qarkullimit të makinave dhe parkingjeve dhe banorët gjobiten në mënyrë të pa drejtë sepse gjoja kanë parkuar gabim dhe kjo është një fushatë e kordinuar midis Policisë Bashkiake dhe Policisë të Shtetit të cilët po i mbytin me gjoba pa asnjë shkak jo po e ke parkuar anash ndaj mendoj se Kryetari i Bashkisë duhet të kordinohen me Policinë e Shtetit që këto ndërhyrje të jenë sa më minimale dhe në radhë të parë të vendosin njëherë rregullat e lojës pastaj ndëshkimet. Në zonat ku janë vetëm për rezidentët duhet që sipas mendimit tim dhe disa specialistëve, kryetari mund ta studiojë edhe me specialistët e tij që parkimi mos jetë 24 orë për rezidentët sepse këta në orën 8 marrin makinën dhe shkojnë në punë në një lagje tjetër dhe zenë vendet e tjera dhe parkingu të jetë 4 ose 5 mbasdite me 8 të mëngjesit gjatë ditë t'ju lihet mundësia atyre që kanë punën atje sepse ata nuk i mbajnë makinat në krahë as në zyrë, do doja që këto tre çështje kryetari ti shikonte dhe të na japë përgjigje sa më të shpejtë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Fjala për z.Kryetar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në lidhje me gjendjen e trafikut në qytet nuk kam konstatuar që të kem një fluks të shtuar të trafikut përveç orareve të caktuar për shembull pjesa tjetër më duket në kufi.

Këshilltar E.Bregu: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani unë ju dëgjova. Unë nuk konstatoj ndonjë fluks përveç orareve që thashë, megjithatë siç ishte dhe një nga pikat e rendit të ditës, siç edhe ju kam informuar një nga ato projektet me financim të huaj është një projekt në kuadrin e marrëveshjes Trilaterale që quhet,

Shqipëri, Itali, Mal i Zi ku ne kemi aplikuar me një projekt në kuadrin e të cilit do bëhet edhe hartimi i planit të menaxhimit të trafikut të qytetit dhe ky plan do ju japë zgjidhjeve problematikave që lidhen me trafikun, korsitë e biçikletave, vendet e parkimit e të tjera. Përsa i përket gjobitjes të padrejtë nga ana e Policisë Bashkiake nuk e di cilës zonë i referoheni por nuk besoj Se policia bashkiake dhe ajo e qarkullimit të kenë gjobitur në mënyrë të padrejtë në mungesë të sinjalistikës horizontale e them këtë me 99.999 % siguri sepse kam patur raste ku nga ana e qarkullimit rrugor na është thënë vendosni që ju lutem vendosni sinjalistikën x në vendin e caktuar që ne të kemi mundësi të ndërhyjmë se pa sinjalistikë nuk ndërhyjmë dot për të vendosur gjoba. Kështu që nuk jam i prirur të ketë ndodhur kjo, nuk di ç'të them. Si rregull atje ku nuk ka sinjalistikë rrugore nuk mund të vendoset gjobë. Në lidhje me pjesën e rezidentëve nuk e di ky propozimi yt sa mund të zbatohet po gjithnjë do jetë kjo kontradita nëpërmjet banorëve që janë rezidentëve ta kenë të rezervuar gjatë gjithë ditës ose të ketë një vendimmarrje që mund t'ja u lerë këtë për orare të caktuar mbase duhet parë praktika e vendeve të tjera.

Këshilltar E.Bregu: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.) dhe nuk ka lagje të tjera?

Sepse dhe lagjeve të tjera ja u zenë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kemi shumë pak aplikime për parkim rezident kryesisht janë hapësira ndërmjet blloqeve të pallateve ku është konstatuar që ka fluks të madh të parkimit dhe ekziston kjo si problematikë por edhe bën sens kjo që të jetë e rezervuar për rezidentët. Mund të jenë tre zona + ose – në qytet. Kështu që e keni pasur mundësinë do e keni edhe në të ardhmen për të diskutuar lidhur me këtë problematikë, të keni një propozim që x zonë që është parkim rezident sot, të hiqet.

Këshilltar E.Bregu: Propozimi im është të venë orare.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ose të jetë me orare, në këtë orar për rezidentë, në orar tjetër për të tjerë, bëjeni si kërkesë në Këshill, të diskutohet, të bëhen edhe ndonjë dëgjuesë publike dhe të merren vendimmarrjet më të mira të mundshme sepse është një diskutim që nuk kënaq gjithë banorët. Jeni të lirë ta bëni të ndjekë këtë rrugë dhe të dalë me një vendimmarrje në Këshill.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z.Petri fjala për ju.

Këshilltar L.Petri: Vura re se z.Kryetar mu drejtua me pyetjen, pse ta bëjmë këtë rezolutë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar L.Petri: Mendoj se meriton vëmendje apo jo znj.Kryetare?

Po, dua ta them shkurtimisht këtë gjë, rezoluta nuk duhet parë vetëm për efektin afatshkurtër dhe emergjent. Nëse ka efekt për këtë gjë sigurisht do ishte e mirëpritur, rezoluta bëhet së pari për seriozitetin e institucionit, ne duhet të tregohemi të unifikuar dhe nuk tregohet serioziteti thjesht me promoncime publike, civilizimet u bënë nga e shkrojtura. Duhet të bëjmë një letër të shkrojtur ku jemi të gjithë të solidarizuar zyrtarisht, përveç se tregojmë seriozitet dhe përfaqësojmë banorë të këtyre zonave, kërkon kjo rezolutë edhe lëvizjen e mallrave edhe heqja e tarifave të doganave, nuk është vetëm bajpassi në këtë mes. Sigurisht është edhe afati, sepse ne dhe me çështje të dorës

të tretë, e kemi me presje vjetore sesa shkon financa për x gjë. Po fatura për këtë të dashur kolegë sa shkon?

Mund të pranojmë ne po na ikën afati, ku çdo ditë për ne është si ai tik taku që po na ikin të ardhurat dhe po bëhen dëme ekonomike?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Z. Tollkuçi ka kërkuar fjalën.

Këshilltar P.Tollkuçi: Jo më kot kam qëndruar në qetësi pasi është çështje shumë e vështirë pajtohëm me kryetarin dhe ju kolegë, nuk është problem i një pjese të vogël qytetarësh por gjithë Qarkut Korçë, kështu që unë uroj vetëm mos ketë një plan që kërkon zgjidhjen emergjente të problemit dhe nga ana tjetër mos jetë ajo palë që uron që mos zgjidhet dhe të ketë sa më shumë pakënaqësi në njerëz dhe një palë që flet pak dhe me punë përpiqet ta zgjidhë sa më shpejt. Unë nuk mendoj se ka një njeri qoftë në pushtetin lokal dhe qëndror i cili të dojë zgjatjen e problematikës të shkaktuar për ato arsye të thëna, kërkohet të zgjidhet sa më shpejt. Jam përsëri i mendimit ku nuk besoj se rezolutat apo fjalët zgjedhin gjë, jam dakort me parafolësin që vendet janë krijuar nga rezoluta por krijohen edhe nga puna. Unë kam parë angazhim në organet e qeverisjes të pushtetit Qendror, për ato kompetenca do japim maksimumin tonë. Unë nuk e di që në mbledhjet e Këshillave ku ka ndodhur kjo në Bashkitë e tjera ka pasur ndonjë rezolutë, mirë do ishte të kishte por kjo vërteton edhe atë pjesën tjetër ku ne jemi prekur në përditshmërinë tonë, Korça preket sidomos në pjesën e turizmit ku e kemi diskutuar, gjithësesi erdhi momenti që u prek nga rruga dhe preket jeta e turizmit. Absolutisht qëndrimi im është për zgjidhjen sa më të shpejtë si qytetar Qarku, si këshilltar dhe kryetar Qarku. Nuk e di se çfarë tjetër të them, është angazhimi im i parë dhe zgjidhja sa më e shpejtë e problemit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Meqënëse gjithë këshilltarët dhanë mendimin e tyre dhe shprehen problematikat unë e mbyll mbledhjen. Shihemi në mbledhjen e rradhës!

SEKRETARE E KËSHILLIT EVA NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK ANA VERUSHI

